



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2818 Prot.

Lezhë, më 3 . 5 . 2022

VENDIM

Nr. 24 Datë 28 . 02 . 2022

PËR

MIRATIMIN E KONTRATËS NDËRMJET AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË
(AKR) DHE BASHKISË LEZHË PËR PROJEKTIN "QENDRA RINORE LEZHË"

Mbështetur në Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin Nr. 75/2019 "Për Rininë", thirrjen për aplikime nga Agjencia Kombëtare e Rinisë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Shkresën Nr. 14901 Prot., Datë 12.08.2021 të Bashkisë Lezhë me lëndë: Shprehje interesi për aplikim për projekt propozime drejtuar Agjencisë Kombëtare të Rinisë si dhe kontratën e grantit me Nr.19199 Prot., datë 05.11.2021 ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Rinisë (autoriteti financues) dhe Bashkisë Lezhë (Përfituesi) për projektin "Qendra Rinore Lezhë", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës ndërmjet Agjencisë Kombëtare Të Rinisë (AKR) dhe Bashkisë Lezhë për Projektin "Qendra Rinore Lezhë".
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

KONTRATË

Nr. 1818 Prot.

Nr. 312 Prot

Sot, më datë 3.11.2021, lidhet kjo kontratë midis palëve si vijon:

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) e krijuar në bazë të VKM Nr. 681, datë 02.09.2020, "Për Krijimin dhe Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë", me NIPT L42408451A, e përfaqësuar ligjërisht nga Znj. Kleina Kasanai, Drejtor i Përgjithshëm, me numër dokument identifikimi BB9009228, në cilësinë e Autoritetit Financues.

Dhe

Bashkia Lezhë e krijuar në bazë të Ligjit Nr. 115/2015 "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë", e përfaqësuar ligjërisht nga Z. Pjerin Ndreu, Kryetar i Bashkisë, me numër dokument identifikimi DD0829700, në cilësinë e Përfituesit.

Neni 1
Baza ligjore

Kjo kontratë lidhet në bazë të Ligjit Nr. 75/2019 "Për Rininë", VKM Nr.681, 02.09.2020 "Për Krijimin dhe Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë", VKM Nr. 1141, datë 24.12.2020 "Për Përcaktimin e Kritereve dhe Procedurave të Përzgjedhjes së Organizatave Rinore dhe/ose Për të Rinjtë që Përfitojnë Financime nga Fondet Grant nga Buxheti i Shtetit, të Dedikuara për Rininë", Neni 659 e në vijim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Objekti i Kontratës

Objekti i kësaj Kontrate është financimi me Grant për zbatimin e Projektit:
"Qendra Rinore Lezhë"

Neni 3
Periudha

Kjo Kontratë hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga palët dhe përfundon me realizimin e të gjitha aktiviteteve të Projektit, brenda një afati 12 (dymbëdhjetë) mujor, siç parashikohet në Formularin e Aplikimit. Si moment i fillimit të zbatimit të projektit të përcaktuar në Nenin 2, do të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

konsiderohet dita e parë e javës së parë sipas Kalendarit të Aktiviteteve (i cili është pjesë integrale e kontratës, por jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4

Shuma e Financimit të Projektit

Shuma totale për zbatimin e projektit është 8,541,077.6 (tetë milion e pesëqind e dyzetë e një mijë e shtatëdhjetë e shtatë pikë gjashtë) lekë. AKR-ja do të mbështesë financiarisht zbatimin e projektit 8,541,077.6 (tetë milion e pesëqind e dyzetë e një mijë e shtatëdhjetë e shtatë pikë gjashtë) lekë që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të buxhetit total.

Neni 5

Mënyra e Financimit të Projektit (Tabela e Pagesave)

Autoriteti Financues do të kryejë Këstin e I-rë prej 90 % të fondit për Përfituesin, jo më vonë se 15 ditë nga nënshkrimi i kësaj Kontrate. Kësti i II-të prej 10%, në përfundim të projektit, jo më vonë se 30 ditë pasi është vlerësuar i suksesshëm përfundimi i tij.

Tabela e pagesave:

Lloji	Shuma që do të paguhet (ne Lekë)	Kushtet	Afati për pagesën
	8,541,077.6 (tetë milion e pesëqind e dyzetë e një mijë e shtatëdhjetë e shtatë pikë gjashtë) lekë.		
Kësti I	(90% e fondit të miratuar për financimin e Projektit).	Firmosja e Kontratës	15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të Kontratës
Kësti II	(10% e fondit të miratuar për financimin e	Miratimi i raportit final	30 ditë pas miratimit të raportit final



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

	Projektit).		
--	-------------	--	--

Neni 6
Detyrimet e përfituesit

Përfituesi detyrohet:

- Të kryejë aktivitetet e përshkruara në Formularin e Aplikimit.
- Të shpenzojë fondet sipas zërave të buxhetit të miratuar, të paraqitur në Formularin e Aplikimit.
- T'i kthejë AKR-së fondet të cilat nuk janë shpenzuar në procedurat e prokurimit publik.
- T'i kthejë AKR-së të gjitha fondet e pashpenzuara brenda 15 ditësh pas përfundimit të Projektit.
- T'i kthejë AKR-së brenda 7 ditëve, pasi raporti final të jetë shqyrtuar, të gjitha fondet të cilat janë përdorur për të mbuluar shpenzimet që AKR nuk i ka miratuar.

Neni 7
Raportimi

Për Projektin që financohet, objekt i kësaj Kontrate, përfituesi duhet të dorëzojë Raportin Financiar dhe Raportin Përshkrues jo më vonë se 15 ditë pas mbarimit të projektit.

Ofertat e procedurave të prokurimit do të kalohen për miratim paraprakisht nga AKR.

Raporti Financiar duhet të plotësohet sipas formatit bashkëlidhur kësaj Kontrate. (Formulari i Raportimit Financiar për Bashkinë Përfituese – pjesë Integrale e kësaj Kontrate).

Ky raport nënshkruhet nga financieri përgjegjës dhe Kryetari i Bashkisë.

Raporti Përshkrues duhet të plotësohet sipas formatit bashkëlidhur kësaj Kontrate (pjesë integrale e kësaj Kontrate), i cili duhet të shoqërohet me jo më pak se 5 (pesë) kopje të çdo publikimi të aktiviteteve, si dhe fotografi apo filmime të aktiviteteve të realizuara. Pjesë e këtij Raporti Përshkrues, do të jetë edhe tabela e plotësuar e aktiviteteve.

Ky raport nënshkruhet nga personi përgjegjës për projektin dhe Kryetari i Bashkisë.

Të gjitha raportet do të miratohen nga AKR-ja brenda 15 ditëve kalendarike, që nga dita e dorëzimit nga përfituesi. Gjatë kësaj periudhe, AKR-ja do të ngrëjë ekipin monitorues për verifikimin dhe kontrollin në vend të Raporteve të lartpërmendura.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Neni 8

Të dhëna mbi llogarinë bankare të përfituesit:

- a) Emri i Bankës së përfituesit :Intesa Sanpaolo Bank
- b) Numri i llogarisë bankare në lekë : 86522530702
- c) Numri IBAN : AL61208540830000086522530702

Neni 9

Përgjegjësia e Përfituesit

9.1 Përfituesi është subjekti përgjegjës për kryerjen me efektivitet të projektit sipas Formularit të Aplikimit.

9.2 AKR-ja nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmtime apo ankesa të shkaktuara nga/dhe nëpërmjet projektit. Përfituesi mban të gjithë përgjegjësinë ndaj palëve të treta.

9.3 Përfituesi sipas rastit, duhet të dorëzojë aktin e vetëdeklarimit në formë zyrtare ku shprehet dhe deklaron se nuk lejon financimin e të njëjtit aktivitet/ iniciativë të objektit të kontratës me shuma të financuara nga subjekte të tjera veç AKR-së.

Neni 10

Monitorimi/Kontrolli

Për çështjet që i takojnë monitorimit të objektit të kësaj Kontrate, palët duhet t'i përgjigjen kërkesës së njëra tjetrës me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike nga dorëzimi i saj.

Përfituesi duhet të ofrojë akses në çdo kohë për ekspertët monitorues të AKR-së, pas njoftimit paraprak të këtyre të fundit, për informacione dhe dokumente që lidhen me projektin dhe zbatimin e tij (duke përfshirë informacionin financiar). Kjo përfshin dhe nënkupton informacion mbi të gjithë projektin dhe jo vetëm mbi pjesën e financuar me fonde nga AKR-ja.

Përfituesi detyrohet të mbajë të gjithë dokumentacionin (duke përfshirë dokumentet financiare) lidhur me projektin të paktën 5 (pesë) vjet pas përfundimit të tij. Gjithashtu, është i detyruar të ofrojë akses në këto dokumente ndaj çdo auditi dhe monitorimi nga ekspertë që përfaqësojnë AKR-në si dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, që ka kompetencë të kontrollojë shpenzimin e fondeve publike.

Neni 11

Publikimi

Përfituesi duhet të vendosë logon e AKR-së në të gjithë informacionin lidhur me aktivitetet që janë mundësuar me ndihmën financiare të AKR-së si dhe mbi të gjitha materialet, aktivitetet, faqet zyrtare të internetit dhe të tjera produkte të përgatitura në kuadër të projektit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Në rastet e publikimit apo prezantimit publik të dokumenteve dhe materialeve të prodhuara në kuadër të projektit, përfituesi merr përsipër të vendosë pohimin e mëposhtëm: "Ky publikim, është mundësuar me mbështetjen financiare të AKR-së."

Me këtë kontratë, përfituesi detyrohet të lejojë AKR-në të publikojë emrin e përfituesit, adresën, qëllimin e projektit, aktivitetet si dhe fondin e marrë, në çdo mënyrë që Agjencia e konsideron të dobishme.

Neni 12

Pronësia e produkteve të projektit

Të gjitha materialet e prodhuara në kuadër të projektit mbeten pronë e Përfituesit. AKR-ja gëzon të drejtën e përdorimit të tyre sipas nevojës dhe në bashkëpunim me bashkinë përfituese, duke patur parasysh kufizimet që rrjedhin nga legjislacioni mbi të drejtën e pronësisë intelektuale.

Neni 13

Ndryshimet e Kontratës

Ndryshimet e rëndësishme në mënyrën/metodën dhe kohën e realizimit të aktiviteteve të projektit mund të ndodhin vetëm pas një miratimi paraprak nga AKR-ja.

Zgjatja në kohë e projektit por dhe shkurtimi i tij ndodh vetëm pas një kërkesë nga Përfituesi e dërguar të paktën 1 (një) muaj përpara përfundimit të projektit dhe miratimit të saj nga AKR-ja.

AKR-ja njoftohet menjëherë në rast se ndodhin ndryshime në adresën, kontaktet dhe numrin e llogarisë bankare të përfituesit.

Ndryshimet në zërat buxhetorë lejohen deri në një total prej 5% të fondit të financuar nga AKR-ja dhe mund të bëhen pa miratimin paraprak të Agjencisë. Përfituesi në këtë rast duhet të njoftojë me shkrim AKR-në në raportin pasues. Ndryshimet prej më shumë se 5%, kalojnë për miratim të AKR-së, të nënshkruara nga personi përgjegjës për projektin dhe për financën.

Në rast ndryshimi të personit përgjegjës për projektin duhet të njoftohet AKR-ja.

Çdo ndryshim tjetër në këtë Kontratë mund të bëhet vetëm nëpërmjet një akti shtesë të nënshkruar nga palët.

Neni 14

Ndërprerja e Kontratës

Kontrata mund të ndërpritet nëse:

- Nuk realizohen aktivitetet në cilësinë dhe sasinë e parashikuar në projektin objekt të kësaj Kontrate, nga Përfituesi për shkaqe të pajustificuara,
- Përfaqesuesi ligjor i Përfituesit ka arsye të rënda shëndetësore/ vdekje.
- Kontrolli i Shtetit ose autoritete të tjera, që me ligj kanë të drejtë të kontrollojnë shpenzimet e fondeve buxhetore, konstatojnë shkelje dhe kjo pranohet nga AKR-ja.
- Ekziston Forcë Madhore, në masën që ajo konstaton se ndërpret zhvillimin e Projektit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Neni 15

Shpenzime të lejueshme/të palejueshme

16.1 Të gjitha shpenzimet duhet të bëhen gjatë periudhës së zbatimit të projektit. Ato duhet të jenë reale dhe të lidhura me aktivitetet në kuadër të projektit, të vërtetuara nëpërmjet Faturave Tatimore.

16.2 Shpenzimet administrative brenda miratimit të buxhetit limit, nuk duhet të lidhen me funksionimin e përgjithshëm të institucionit dhe duhet të jenë të lidhura direkt me aktivitetet specifike të projektit.

Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të lejueshme dhe nuk mbulohen me fondin e Grantit që financojnë Projektin:

- Blerje e tokës.
- Shit-blerje makinash.
- Interes mbi huadhënie
- Marrëveshje huadhënie.
- Dhurime.
- Financim i partive politike apo organizatave e grupeve fetare.
- Veprime dhe aktivitete në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 16

Sanksionet

Moszbatimi i detyrimeve për afatet e paraqitjes së raporteve financiare dhe Përshkruese, sjell paralajmërimin e Përfituesit, ndërprerjen e financimit dhe përjashtimin nga financimi i projekteve për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Në rastin e mospërbushjes së aktiviteteve të projektit apo kryerjes së shpenzimeve që nuk kanë qenë të lejuara, pjesa respektive e buxhetit do t'i kthehet AKR-së.

Në rastin kur dëmtohet cilësia e aktiviteteve të projektit, Përfituesi detyrohet t'i kthejë AKR-së shumën/at e përdorur/a për financimin e këtyre aktiviteteve dhe/ose materiale publikuese.

Në rast se fondet e financuara me anë të këtij Granti, nuk janë shpenzuar sipas zërave të buxhetit të miratuar në Projekt Propozimin e Plotë, shuma e shpenzuar jo në përputhje me zërat e buxhetit do t'i kthehet AKR-së dhe Përfituesi detyrohet të paguajë një gjobë prej 10% të grantit të financuar nga AKR-ja.

Neni 17

Zgjidhja e konflikteve

Në rastet e mosmarrëveshjeve dhe mospërbushjes së detyrimeve nga palët, për çështjet e financimit, raportimit dhe monitorimit të zbatimit të projektit objekt i kësaj kontrate, ato do të kenë 30 ditë afat për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

zgjidhjen me mirëkuptim të konfliktit. Nëqoftëse, brenda kësaj periudhe nuk arrijnë në një marrëveshje, palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 18
Të ndryshme

Ndryshimet dhe shtesat e kësaj Kontrate bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dyja palët. Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë të palëve dhe përcakton në mënyrë ekskluzive afatet dhe kushtet lidhur me objektin e saj.

Për çështje që nuk parashikohen specifikisht në këtë Kontratë, palët do t'i referohen Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë,

Kjo Kontratë është hartuar dhe lidhur në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë ligjore, nga të cilat 2 (dy) i mban AKR-ja dhe 1 (një) Përfituesi.


Pasi u lexua nga palët, Kontrata nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë.

Kjo kontratë nënshkruhet nga :

Për AKR-në:

Znj. Kleina Kasari

Drejtor i Përgjithshëm



Për Përfituesin:

Z. Pjerin Ndreu

Kryetar i Bashkisë

